



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 635/4 Prot.

Vlorë më, 11.02.2025

VENDIM

Nr. 7, datë 10.02.2025

PËR

NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.43, DATË 15.11.2021 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT "DOKTORATË" NË "STUDIME GJUHËSORE, LETRARE E KULTURORE",

Në mbështetje të nenit, 38, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar shkresës 114/1, prot, datë 07.02.2025, prot pranë nesh me Nr.607, datë 07.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në Fakultetin e Shkencave Humane, për një ndryshim në vendimin nr.43, datë, 15.11.2021 "Për miratimin e rregullores për organizimin e ciklit të tretë të studimit "doktoratë" në "studime gjuhësore, letrare e kulturore", si më poshtë vijon:

Ishte: Neni 10, pika 2, shkronja e e Rregullores

e) Të zotërojë një prej gjuhëve të bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), niveli C1, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatët që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë.

Bëhet: Të zotërojë një prej gjuhëve të bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), niveli B2, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatët që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. Aurela Sulha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

Nr. 114 / prot.

Vlorë, më 07.02.2025

Lënda: Përcjellje e kërkesës për një ndryshim në vendimin e Senatit akademik nr 43, datë 15.11.2021 " Për miratimin e rregullores për organizimin e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore".

PROF. DR. AURELA SALIAJ,

REKTORE E UV-së

KËTU

Në mbështetje të nenit 42, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 7 të Nenit 7 të Rregullores së Brendëshme të UV-së, Ju përcjellim kërkesën e drejtueses së departamentit të gjuhëve të huaja dhe drejtueses së departamentit të gjuhës shqipe dhe letërsisë, për një ndryshim në vendimin e Senatit akademik nr 43, datë 15.11.2021 "Për miratimin e rregullores për organizimin e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore".

Bashkëlidhur gjeni kërkesën e përcjellë nga dy departamentet.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEKAN
Prof. Dr. Roland Zisi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Nr. 144 prot.

Vlorë, më 07.02.2025

Lënda: Përcjellje e kërkesës për një ndryshim në vendimin e Senatit akademik nr 43, datë 15.11.2021 "Për miratimin e rregullores për organizimin e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore"

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE
PROF. DR. ROLAND ZISI

KËTU

I nderuar Z. Dekan,

Mbështetur në nenin 78 të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit Ismail Qemali, Vlorë, si edhe bazuar në Udhëzimin Nr. 10 datë 16.06.2023 "Për një ndryshim në udhëzimin 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, ju përcjellim kërkesën për miratim në Senatin Akademik të ndryshimit të nenit 10, pika (e) të Rregullores së Ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore".

Në rregulloren aktuale është :

e) Të zotërojë një prej gjuhëve të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), niveli C1, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatë që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë

Propozohet të ndryshohet si më poshtë

e) Të zotërojë një prej gjuhëve të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), niveli B2, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatë që kanë fituar një diplomë të një programi studimi që nuk është kryer në një nga këto gjuhë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT
PROF.AS. KOZETA HYSO

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT
PROF.AS.MONIKA HASANI